# DËSHMI ARKIVI

**A-470652**

VERSIONI 5

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Liga e Kombeve/ Shqipëria pret sot Bjellorusinë në 'Air Albania', Maran nis aventurën me kuqezinjtë! Asll ani rikuperohet nga dëmtimi, ja formacioni i mundshëm - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/liga-e-kombeve-shqiperia-pret-sot-bjellorusine-nw-air-albania-maran-nis-aventuren-me-kuqezinjte-4-lojtare-ne-tribune-laci-mungon-prej-demtimit` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 06:57:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 06:54:36 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `38b8e0594a626c6fab201c5bb1c216f143cad4baf98f78fef8ff18f0944759a4` |
| TEKSTI | `a60b92cd26fb7b52d33bcb3072cb59ed1d90ae3e637799dafbae398d274fe16e` |
| PAMJA | `ac244a96efbbe242f91b6b843e2a6f8335d8c6656f146169f495d8126941fd37` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7882b820b8c9ef3218cf4db640eaaf208cf68d7cbf7968619c95912861e826f3` |
| E MËPARSHMJA | `a18f0f242f28543695e0612699461f9894bcb4bb3e4e18f15982561e2acc225b` |
| RRËNJA MERKLE | `2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7882b820b8c9ef3218cf4db640eaaf208cf68d7cbf7968619c95912861e826f3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1  Kush është ambasadori i ri amerikan Eric Wendt dhe 4 prioritetet e tij

Sport

# Liga e Kombeve/ Shqipëria pret sot Bjellorusinë në 'Air Albania', Maran nis aventurën me kuqezinjtë! Asllani rikuperohet nga dëmtimi, ja formacioni i mundshëm

*Sonte në 20:45 kombëtarja do të ketë sfidën me Bjellorusinë në stadiumin Air Albania. Kuqezinjtë kanë mbyllur përgatitjet, ndërsa tekniku Maran tha një ditë më paë se ka parë shumë dëshirë te futbollistët në 5 ditë përgatitje. Italiani nuk zbuloi asgjë rreth formacionit, por siguroi që Kristjan Asllani ka lënë pas dëmtimin.*

Ndeshja/ Nga ora 17:00 bllokohen rrugët rreth stadiumit 'Air Albania'



*Kuqezinjtë pas përgatitjeve për ndeshjen me Bjellorusinë*

Redaksia
26 Shtator, 08:51 | **Përditësimi: 26 Shtator, 10:25**

Share Tweet

Kombëtarja shqiptare mbylli të premten përgatitjet dhe është gati për sfidën e parë në Ligën e Kombeve, që luhet sonte në orën 20:45 në stadiumin Air Albania kundër Bjellorusisë.

Atmosfera duket pozitive te kuqezinjtë, me lajmin e mirë që vjen nga Asllani i cili ka lënë pas dëmtimin, i cili pritet në formacion sonte. Portën do ta mbrojë Etrit Berisha, në mbrojtje do të luajnë Hysaj, Ismajli, Gjimshiti dhe Pilo. Përveç Asllanit edhe Ramadani pritet në mesin e fushës, ndërsa në repartin e sulmit do të kemi 'popullim' dhe pritet që nga minuta e parë të luajnë Hoxha, Seferi, Muçi dhe Manaj. Për sfidën me Bjellorusinë, Maran ka lënë në tribunë Luis Hasën, Sabah Kerjotën dhe portierin Simon Simoni.

Në prag të takimit trajneri Rolando Maran tha se shikon shumë dëshirë te kuqezinjtë në këtë grumbullim të parë.



LEXO EDHE:
**Sot ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia plan masash! Nga ora 17:00 bllokohen rrugët rreth stadiumit 'Air Albania'**

> *"Kam parë dëshirë për të punuar dhe për të gjetur stimujt e duhur përtej kundërshtarit. Për mua kjo është gjëja më e rëndësishme, që të përqendroheshim te cilësitë tona. Kam parë diçka ndryshe këto ditë dhe dëshirë të madhe për të provuar, por edhe për të gabuar. Gabuar në aspektin që të përmirësohemi në të ardhmen", tha Maran.*



*Gabuar në aspektin që të përmirësohemi në të ardhmen", tha Maran.*

Sfidën kundër Bjellorusisë Maran e konsideroi si nisjen zyrtare të aventurës me Shqipërinë, duke lënë pas dy humbjet në miqësore gjatë qershorit. Në total kuqezinjtë kanë 5 humbje radhazi. Ndryshe nga Bjellorusia që pasi preku fundin me trajnerin e ri nuk njeh humbje në 2026. Në 4 ndeshje ka 1 barazim dhe 3 fitore.

> *"Bjellorusia vjen nga një periudhë e mire. Ka bërë rezultat në 6 ndeshje radhazi dhe kjo do të thotë diçka. Për ne duhet të jetë stimul përtej emrit që ka kundërshtari", vijoi Maran.*

Kapiteni Berat Gjimshiti saktësoi se objektivi në këtë Ligë Kombesh është vendi i parë në grup.

> *"Ke njëlloj presioni, sepse të gjithë kanë pretendime për vendin e parë. Të gjithë e kemi, edhe unë vetë jam një lojtar që kërkoj maksimumin. Nuk e kishim këtë fat ndaj Polonisë. Do të ishte një arritje e madhe, por duam të përsërisim Evropianin për herë të tretë", tha Maran.*

Shqipëri-Bjellorusi do të arbitrohet nga gjyqtarë anglez të Premier League, me kryesor Sam Barrott. 3 ditë pas këtij dueli do të jetë sfida e dytë në Ligën e Kombeve kundër San Marinos në transfertë, e më pas më 3 tetor ndaj Finlandës dhe më 6 tetor sërish ndaj San Marinos në Tiranë.

SI.E./Shqiptarja.com

**TAG:** Rolando Maran | Liga e Kombeve | Air Albania | kombetarja shqiptare

**Sa e vlerësoni këtë artikull?** 1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 22 Shtator, 16:08

**Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?**

Po | Jo | Disi

## Lajme të tjera



**Liga e Kombeve, Kombëtarja mbyll përgatitjet për ndeshjen ndaj Bjellorusisë në stadiumin 'Air Albania'**

25 Shtator, 18:32



**'Nesër nis aventura ime me Shqipërinë', trajneri Maran: Asllani do jetë gati! Gjimshiti: Vendi i parë në grup sjell presion**

25 Shtator, 16:34



**Futbollisti i Izraelit 'shkrep armën' gjatë festës në Ligën e Kombeve, arbitri e përjashton nga fusha (VIDEO)**

25 Shtator, 12:54



**Përmbysi kombëtaren e origjinës, trajneri serb i Greqisë 'shpërthen' me fjalorin pas golit (VIDEO)**

25 Shtator, 12:29



**Sfida me Bjellorusinë, Asllani dhe Cake shqetësojnë Maran! Formacioni, balotazh në portë mes Strakoshës dhe Sherrit**

25 Shtator, 11:35



**Supersfida e debutuesve në Ligën e Kombeve, Holanda e Xavi-t barazon Gjermaninë e Kloop! Greqia përmbys Serbinë, merr kreun e grupit (VIDEO)**

25 Shtator, 09:32







**Spektakli ‘firmoset’ nga Muriqi, Kosova mposht Irlandën dhe ndan kreun me Austrinë! Vata në stol për 90 minuta (VIDEO)**
24 Shtator, 22:43

**Liga e Kombeve/ Përgatitjet për Bjellorusinë, trajneri Maran provon skemat taktike! Asllani bën stërvitje të diferencuar, Cake në rikuperim**
24 Shtator, 19:52

**UEFA Nations League/ San Marino – Shqipëri, shiten të gjitha biletat për tifozët shqiptarë**
24 Shtator, 17:51



**Në fushë jo vetëm Kombëtarja, UEFA cakton 6 arbitra nga Shqipëria për ndeshjen e Ligës së Kombeve**
24 Shtator, 16:48



**Liga e Kombeve/ Sonte debutimi i Xavi Hernandez dhe Kloop në supersfidën Holandë-Gjermani, përballë edhe Serbia kundër Greqisë**
24 Shtator, 12:58



**'U emocionova nga mesazhi', debutuesit e Kombëtares rrëfejnë ftesën nga Maran! Qefalija e Sina: Prindërit s'e besonin**
24 Shtator, 11:15



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.